

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti i Krimeve të Rënda- kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryetar, Mejreme Memaj e Fllanza Kadiu, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Arta Dumani, procesmbajtëse, në çështjen penale të të akuzuarve G.R., me nofkën “...”, nga Prishtina, lagjja “...”, për veprën penale vrasje e rëndë, parashikuar me nenin 147 par.4 lidhur me nenin 24 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), dhe veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 374 par.1 të Kodit penal të Republikës së Kosovës(KPRK), dhe A.I., nga Prishtina, lagjja “”, rruga “...”, p.n., për veprën penale shtytje në vrasje të rëndë, parashikuar me nenin 147 par.4 lidhur me nenin 24 të KPK, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit Themelor në Prishtinë, atë të akuzuarit G. dhe mbrojtësit të tij avokatit S.G., ankesën e përbashkët të mbrojtësve të të akuzuarit A.I. avokatëve R.D. e H.P. dhe përgjigjes në ankesën e Prokurorit nga mbrojtësi i të akuzuarit G., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.291/2014 datë 18 shkurt 2016, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), me 16 shtator 2016, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

I. Me miratimin e pjesshëm të ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit G.R., aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.291/2014 datë 18 shkurt 2016, përkitazi me këtë të akuzuar ndryshohet për cilësimin juridik të veprës penale në pjesën nën pikën I. të dispozitivit dhe vendimin për dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit gjen se në veprimet e të akuzuarit G. të përshkruara në atë pikë të dispozitivit, pasqyrohen elementet e veprës penale vrasje, parashikuar me nenin 146 të KPK, dhe për këtë vepër e shpall fajtorë dhe e gjykon me 16(gjashtëmbëdhjetë) vite burgim, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej 3.01.2009 e tutje. Dënimi me gjobë - në shumën prej 2000 (dymijë) €, i shqiptuar për veprën penale, nga neni 374 par.1 të KPK merret i vërtetuar.

II. Ndërsa, me aprovimin e ankesës së përbashkët të mbrojtësve të të akuzuarit A.I., aktgjykimi përkitazi me këtë të akuzuar ndryshohet ashtu që ky i akuzuar konform dispozitës së nenit 364 par.1 pika 1.1 të KPP lirohet nga akuza se:

“ Në kohë dhe vend si nën dispozitivin nën I të kësaj akuze me dashje shtyti të akuzuarin G.R.n, që ta privojë nga jeta tani të ndjerin A.G.n në atë mënyrë pasi doli nga automjeti “Tojota”, iu afrua veturës së të pandehurit A.K., “Audi A6”, që ishte parkuar para dyerve dalëse të restorantit “NN1”, duke sharë, fyer, bërtitur tenton ta godas përshitazi me boksë në fytyrë të pandehurin A.K., derisa i njëjti ishte me të tjerët në veturën e tij, e të cilët duke e ndier vetën të provokuar nga veprimet e të pandehurit A.I. dalin të gjithë nga vetura dhe e sulmojnë fizikisht me shufër metalike, ndërsa, me pistolet e qëllon i pandehuri A.K. duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore. E gjithë ngjarja ka ndodhur me qëllim të qërimit të hesapeve për shkak të konfliktit të një nate me parë që kishte ndodhur ne restorantit “NN2”, në Prishtinë, në mes të këtyre dy grupeve rivale-vëllezërve R. të pandehurit A.I. e të tjerëve nga njëra anë dhe të pandehurit A.K. e të tjerëve nga ana tjetër. Veprimet e ndërmarra nga i pandehuri A.I. kanë kontribuar thelbësisht në shtytjen e të pandehurit G.R. që më dëshirë ai të merr armën nga automjeti i tij “Taureg”, i cili pastaj ka shtënë në drejtim të tani të ndjerit A.G. dhe në personat e tjerë që ishin në oborrin e restorantit,

-Me çka kishte për të kryer veprën penale shtytje në vrasje të rëndë, parashikuar me nenin 147 par.4 lidhur me nenin 24 të KPK

Për shkak se në veprimet e tij nuk formohen elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar

Shpenzimet e procedurës penale përkitazi me ketë të akuzuar i ngarkohen mjeteve buxhetore të Gjykatës.

III. Ankesa e Prokurorit për dënimin për të akuzuarin G.R. refuzohet si e pabazuar.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i krimeve të rënda, me aktgjykimin PKR.nr.291/2014 datë 18 shkurt 2016 të akuzuarin G.R. e ka shpall fajtor për veprat penale vrasje e rëndë, parashikuar me nenin 147 pika 4 lidhur me nenin 24 të KPK dhe veprën penale të armëmbajtjes pa leje, parashikuar me nenin 374 par.1 të KPK dhe e ka gjykuar për veprën penale nga neni 147 par.4 të KPK me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 19 (nëntëmbëdhjetë) viteve në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 3.01.2009 e tutje, kurse për veprën penale të armëmbajtjes pa leje dënim me gjobë në shumë prej 2000(dymijë)€, kurse të akuzuarin A.I. e ka shpall fajtor për veprën penale shtytje në vrasje të rënde, parashikuar me nenin 147 par.1 pika 4 lidhur me nenin 24 të KPK për të cilën e ka gjykuar me 5(pesë) vite burgim në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 3.01.2009 deri me 4.11.2013. Konform dispozitës së nenit 54 lidhur me nenin 60 të KPK ndaj të akuzuarit G. është shqiptuar edhe dënimi plotësues – konfiskimi i pushkës automatike AK-47 kal.7.65x39 mm, me numër serik 4219392 prodhim kinez. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil. Të akuzuarit janë obliguar që të paguajnë shpenzimet e procedurës

penale aq sa do të jenë sipas llogarisë së Gjykatës, kurse në emër të paushallit gjyqësor i akuzuari G. është obliguar që të paguaj 300€, kurse i akuzuari A. 200€.

Kundër këtij aktgjykimi kanë paraqitur ankesa të afatshme:

-Prokurori Themelor në Prishtinë, vetëm për shkak të vendimit për dënim, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që ndaj të akuzuarve të shqiptohen dënime me të ashpra me burgim,

-mbrojtësi i të akuzuarit G.R., avokati S.G., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshojë atë përkitazi me veprën penale të vrasjes së rëndë, parashikuar me nenin 147 pika 4 të KPK ose të ri cilësuar sipas nenit 146 të KPK në mungesë të provave bazuar në parimin “in dubio pro reo” ta liroj nga akuza, ose veprimet e të akuzuarit të përshkruar nën pikën I e II të aktgjykimit të ri cilësohen si veprë penale mbajtja, në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 par.1 të KPK dhe për këtë veprë ti shqiptoj një dënim adekuat, ose aktgjykimi të anulohet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, kurse për veprën penale nga neni 328 të refuzohet akuza për shkak se vepra është përfshirë në amnisti. Në rast se lënda kthehet në rigjykim ka kërkuar që lënda i caktohet një trupi gjykues tjetër,

-i akuzuari G.R., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, me propozim të njëjtë si mbrojtësi i tij,

Mbrojtësit e të akuzuarit A.I., avokatët R.D. e H.P.( ankesë të përbashkët), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu i akuzuari të lirohet nga akuza për veprën penale për të cilën është akuzuar apo anulohet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim,

Mbrojtësi i të akuzuarit G.R., ka dhënë edhe përgjigje në ankesën e Prokurorit Themelor në Prishtinë, me propozim që ajo të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit e caktoi seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPP, për të cilën i njoftoj palët. Në seancë prezantoi i akuzuari G.R., mbrojtësit e tij avokati S.G. dhe E.K.( e angazhuar në fazën ankimore), i akuzuari A.I. dhe mbrojtësit e tij avokatët R.D. e H.P.. Kurse, prokurori i Apelit edhe pse i njoftuar me rregull nuk mori pjesë në seancë, por me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.319/2016 datë 21.06.2016 ka propozuar që ankesa e Prokurorit të aprovohet si e bazuar, kurse ankesa e të akuzuarit G., mbrojtësit të tij dhe ajo e mbrojtësve të të akuzuarit A.I. të refuzohen si të pabazuara. Gjykata ka tentuar që për seancën e kolegjit ta njoftoj edhe palën e dëmtuar, por njoftimi ska mund ti dorëzohet ngase sipas konstatimit në fletëkthesë i dëmtuari gjendet jashtë vendit. Mbrojtësit e të akuzuarve pasi që sqaruan disa nga pretendimet ankimore mbështeten propozimet e bëra në ankesa, kurse të akuzuarit i mbështeten mbrojtësit e tyre.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, i vlerësoi pretendimet ankimore dhe konstatoi:

Ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit G.R. është e bazuar pjesërisht, ajo e mbrojtësve të të akuzuarve A.I. është e bazuar, kurse ankesa e Prokurorit për dënimin për të akuzuarin G. nuk është e bazuar.

## I

Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me pretendimet ankimore të mbrojtësve të të akuzuarve përkitazi me shkeljet esenciale

Pa marrë parasysh se në ankesën e të akuzuarit G. atë të mbrojtësit të tij dhe mbrojtësve të të akuzuarit A. pretendimet ankimore përkitazi me bazën ankimore të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale janë ngushtë të ndërlidhura me ato përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljen e ligjit penal, Gjykata e Apelit do të jap vlerësime më poshtë veç e veç për çdonjërin bazë.

Kështu, përkitazi me bazën ankimore të shkeljeve esenciale në ankesat e të akuzuarit G. dhe mbrojtësit të tij kryesisht pretendohet se aktgjykimi i shkallës së parë mbështetet në prova të papranueshme, nga neni 384 par.1 par.1.8 të KPP, ngase ekspertiza e përbashkët e ekspertit mjeko ligjor T.G. dhe atij të balistikës H.K., janë prova të papranueshme në kuptim të dispozitës së nenit 152, 153 dhe 154 të KPP, ngase asnjëri nga këta ekspert nuk ka legjitimitet për të vepruar si ekspert, ngase nuk ishin e as nuk janë pjesë e Departamentit të Mjekësisë Ligjore e as Agjencionit Kosovar të Forenzikës dhe nuk kishin licencë të ekspertit. Pastaj, në ankesa pretendohet se aktgjykimi është i përfshirë edhe me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1.12 pika 1.12 lidhur me nenin 370 par.1, 2, 3, 4, 6, 7 dhe 8 të KPP, ngase aktgjykimi është i pakuptueshëm, kundërthënës në vetvete dhe me arsyet e paraqitura në arsyetimin e aktgjykimit dhe ka kundërthënie me përmbajtjen e deklaratave kryesore dhe përmbajtjen e procesverbaleve nga shqyrtimet gjyqësore. Ndersa, mbrojtësit e të akuzuarit A. në ankesën e tyre të përbashkët pretendojnë se dispozitivi i aktgjykimit përkitazi me të mbrojturin e tyre është i pakuptueshëm, kundërthënës me brendinë e tij ose arsyet e aktgjykimit, kurse në arsyetim nuk janë paraqitur arsye lidhur me faktet vendimtare. Në fakt sipas pretendimeve ankimore në dispozitiv të aktgjykimit të kundërshtuar nuk ka përsëritje të fakteve dhe rrethanave që përbejnë figurën e veprës penale –shtytje në vrasje të rendë, parashikuar me nenin 147 par.4 lidhur me nenin 24 të KPK për të cilën është akuzuar dhe shpall fajtor i akuzuari A., kurse as nga provat e administruara nuk vërtetohen elementet e kësaj vepre penale.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e mësipërme ankimore nuk janë të bazuara. Aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat pretendohet në ankesa dhe as që ka shkelje tjera të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare e të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij.

Nga fakti se eksperti i Balistikës H.K. dhe ai i mjekësisë ligjore T.G. nuk janë ekspert të Departamentit të Mjekësisë Ligjore dhe Agjencionit Kosovar të Forenzikës nuk mund të të konkludohet se ekspertiza e tyre është e papranueshme si provë, ngase një gjë e tillë nuk është kërkuar sipas Kodit të Procedurës Penale i cili ishte në fuqi në kohën kur janë caktuar këta ekspertë, dhe as sipas Kodit të Ri të Procedurës Penale. Sipas nenit 175 të KPP ( 6 pill 2004) i cili ishte në fuqi në kohën kur janë caktuar këta ekspert, ekspertimi caktohet kur për vërtetimin ose vlerësimin e ndonjë fakti të rëndësishëm duhet të merret konstatimi dhe mendimi nga specialisti i cili posedon njohuri të nevojshme profesionale, kurse sipas nenit 176 par.1 të të njëjtit kod ekspertimin e urdhëron gjykata me shkrim në bazë të kërkesës së prokurorit publik, të mbrojtësit ose sipas detyrës zyrtare. Nga shkresat e lëndës del se këta ekspert janë caktuar me urdhrin e gjykatës në bazë të kërkesës së prokurorit publik. Pastaj, pa bazë pretendohet se këta ekspertë nuk janë të licencuar, ngase veprimtarinë e tyre si ekspert e ushtrojnë në firmat e tyre private me lejen e Ministrisë përkatëse. Ndërsa, sa është ekspertiza e tyre zgjidhje objektive e çështjes që do të jepen vlerësime në kuadër të gjendjes faktike. Ndërkaq, konkludimet e Gjykatës përkitazi me veprat penale për të cilat i akuzuari G. dhe A. janë shpall fajtor në raport me gjendjen faktike të vërtetuar sipas vlerësimit të kësaj Gjykate janë të gabuara, konkludime këto që i përkasin edhe zbatimit të ligjit penal për çka edhe në këtë drejtim do të behet fjalë me poshtë në kuadër të gjendjes faktike.

a) Pretendimet ankimore përkitazi me gjendjen faktike dhe zbatimin e ligjit penal.

Sa i takon bazës ankimore të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, i akuzuari G. dhe mbrojtësi i tij në ankesat e tyre në esencë e kontestojnë mënyrën se si janë vlerësuar provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë si dhe konkludimet të cilat i ka nxjerrë ajo në bazë të provave të proceduara. Kështu, përpos që kontestohet ekspertiza e kryer nga eksperti i balistikës H.K. dhe ai i mjekësisë ligjore T.G. në aspektin e pranueshmerisë si provë për arsyet e lartcekura, theksohet se gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë ekspertizë të re sipas vërejtjeve të Gjykatës së Apelit e cila e udhëzoi gjykatën e shkallës së parë të nxjerr prova të reja rreth ekspertizës së re ngase ekspertiza e bërë nuk ishte nuk është në përputhje me Ligjin mbi Agjencionin e Forenzikës. Kurse, kur një gjë e tillë e beri kërkoj nga ky Agjencion që të japin mendimin e tyre se me çfarë lloji të armës është shkaktuar plaga në trupin e të ndjerit A.G. vetëm në bazë të dokumentacionit. Pas konstatimit dhe mendimit të eksperteve të Agjencionit të Forenzikës në këtë drejtim krye shefi ekzekutiv i Agjencionit të Forenzikës me parashtresën me shkrim nr.AKF/2015-388 datë 3.12.2015 deklaroj se përgjigjja e eksperteve është analizë dhe dhënie e mendimit të eksperteve vetëm në bazë të dokumentacionit të analizuar, por jo ekspertizë apo super ekspertizë të cilat kryhen me kërkesë apo urdhërese të Prokurorisë dhe Gjykatave e të cilat trajtohen me procedura të brendshme teknike dhe mbi bazë të provave dhe dëshmimeve, ndërsa, në kërkesën e gjykatës për Super Ekspertizë ky Agjencion ka dhënë raport me shkrim se nuk ka metoda të validuara për një gjë të tillë. Ndërsa, në vend që të ftoj dhe të dëgjoj patologun Dr.M.G. i cili e kreu autopsinë e të ndjerit e dëgjoj Dr.N.U. i cili ishte asistent i Dr. M.. Prandaj, sipas ankesës ka mbetur dubioze lloji dhe kalibri i armës prej së cilës është hedhur predha vdekje pruerëse kur kihet parasysh fakti se në këtë ngjarje janë përdorur tri apo me shumë armë. Me tutje sipas ankesës asnjëri nga dëshmitarët e dëgjuar (Y.D.,

B.K., G.Sh. e Sh.D.) as në hetime as në shqyrtimet gjyqësore nuk e kanë konfirmuar faktin se i akuzuari G. ka shtënë në drejtim të të ndjerit, ndërsa, dëshmitari okular i kësaj çështje Sh.D. i cili ka dëshmuar me së paku tri në këtë çështje e edhe me rastin e rikonstruimit të vendit të ngjarjes qartë dhe bindshëm ka shpjeguar se G. kur ka dal nga vetura e tij ka gjuajtur naltë -rafall 2 herë nga 4-5 predha dhe se po të gjuante drejtë ka pas mundësi siç është deklaruar ai “me na fut tanëve”. Me tutje, sipas ankesës konstatimet në dispozitiv të aktgjykimit “se me dashje që ta privojë nga jeta tani të ndjerin ....me vetëdije shtënë disa herë në drejtim të tani të ndjerit ....dhe me atë rast me dashje rrezikon jetën e shumë personave tjerë që ishin në oborrin e restorantit” nuk kanë mbështetje në asnjë provë materiale e as verbale të administruara në shqyrtimet gjyqësore, ngase i akuzuari të ndjerin nuk e ka njohur fare, prandaj parashtrohet pyetja si ka mundësi që dikush ta dëshiron pasojën e personit që nuk e njeh, dhe me të cilin nuk ka pasur ndonjë problem me parë. Faktet se shtënat nga G. janë bërë në ajër dhe rafal, se në vendin ku është qëlluar i ndjeri ka pasur shumë persona, se ka pas të shtëna nga me së paku tre armë zjarri e bëjnë të paqëndrueshëm dhe aspak të besueshëm ekspertizën e eksperteve e cila është e vetmja provë në favor të akuzës. Prandaj, me qëllim që të vërtetimit të shkaktarit të vërtetë i cili ia mori jetën të ndjerit A.G. pretendohet se ka qenë e nevojshme të behet një Super Ekspertizë nga një grup i eksperteve të balistikës dhe mjekësisë ligjore ose nga ndonjë Institucion respektabil i jashtëm. Meqë sipas ankesave nuk është vërtetuar përgjegjësia penale për veprën penale për të cilën është akuzuar i akuzuari vetmi vendim i drejtë në këtë çështje është lirimi nga akuza duke aplikuar parimin “In dublo pro reo-nenin 3 par.2 të KPP”, ndërsa, në rast se gjykata gjen se në veprimet e tij qëndrojnë elementet e veprës penale nga neni 328 par.1 të KPPK t’i shqiptohet një dënim i merituar, kurse për veprën penale nga neni 328 par.2 të KPP pretendohet se gjykata duhet të merr aktgjykim refuzues për shkak se vepra penale është përfshirë në amnisti.

Kurse, përkitazi me këtë bazë ankimore edhe mbrojtësit e të akuzuarit A. në ankesën e tyre të përbashkët kontestojnë konkludimet e gjykatës në bazë të provave të administruara. Sipas këtyre mbrojtësve është fakt i pakontestueshëm se në këtë ngjarje është privuar nga jeta A.G. dhe tentuar të privohet nga jeta A.I. duke u qëlluar me armë zjarri dhe shkaktuar lëndime të renda trupore, i cili ishte në restorantin “NN1” për të festuar natën e dytë të vitit të ri, dhe në gjendje të dehur është rrahur me mjete të forta dhe është qëlluar me armë zjarri. Mirëpo, nuk ka prova të cilat argumentojnë faktin se i akuzuari A. e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Vetë përshkrimi i veprimeve inkriminuese në dispozitiv të aktgjykimit nuk është koherent me gjendjen faktike dhe provat e administruara, ngase nuk është vërtetuar se i akuzuari A. e ka shtytur akuzuarin G. për ta kryer veprën penale të vrasjes siç pretendohet. Sipas mbrojtësve është juridikisht e papranueshme që i akuzuari shpallet fajtor për shtytje kur kihet parasysh fakti se për të ekzistuar shtytja duhet të ekzistojë dashja me e sjell personin tjetër në kryerje të veprës penale, e që në fakt ka për pasojë edhe prurjen e vendimit të kryesi i veprës penale. Me tutje mbrojtësit elaborojnë mënyrën se si kryhet shtytja duke pretenduar se në rastin konkret me asnjë provë nuk është provuar se i akuzuari A. e ka shtyt të akuzuarin G. që ta kryejë veprën penale të vrasjes se rendë. Ndërsa, si pasojë e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike të gjithë mbrojtësit pretendojnë se është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarve.

Kështu, siç del nga shkresat e lëndës në këtë çështje juridiko penale nuk është kontestuese se kjo ngjarje ka ndodh me 2.01.2009 rreth orës 2 e 30 në Prishtinë përpara restorantit “NN1”, në lagjen e .... Si shkas i kësaj ngjarje është përleshja fizike në “NN2”, në Prishtinë që kishte ndodh një natë me parë në mes të akuzuarit A.K. dhe shokëve të tij dhe të akuzuarve A.I., Xh.C. dhe G.R. ( vëllait të të akuzuarit G.). Me 2.01.2009 të akuzuarit G. e G.R.2, A.I., A.C. dhe Xh.C. po festonin në restorantin “NN1” vitin 2009, me vonë në restorant shkojnë edhe A.K., së bashku me vëllain e tij A., djalin e axhës J. dhe shokun e tyre A.F., dhe pasi që A. sheh personat me të cilët është përleshur fizikisht me ta, teton të bisedoj me ta për shkak të ngjarjes së një nate me parë, por, me ndërmjetësimin e të pranishmeve arrihet që të evitohet ky kontakt. Situata eskalon duke dal nga restoranti dhe ngjarja zhvillohet para dyerve të restorantit. Fillimisht fillon një konflikt fizik në mes të akuzuarit A.I. dhe të akuzuarve A.K., A.K.( vëllai i të akuzuarit A.), J.K. dhe A.F., në të cilin konflikt involvohen edhe të tjerët, me ç’rast edhe përdoren armë, ku si pasojë e të shtënave me armë vdes i ndjeri A.G., kurse plagoset rëndë i akuzuari A.I.. Përkitazi me këtë ngjarje me akuzën e Prokurorit, i akuzuari G.R. akuzohet për veprën penale të vrasjes së rëndë, parashikuar me nenin 147 par.4 të KPK, i akuzuari A.I. për veprën penale shtytje të akuzuarit G. në kryerjen e veprës penale vrasje e rënd, nga neni 147 par.4 lidhur me nenin 24 të KPK, A.K. për veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë në dëm të të akuzuarit A.I., nga neni 147 par.9 lidhur me par.4 dhe nenin 20 të KPK, kurse të akuzuarit G.R.2, Xh.C., A.C. e A.F.. për veprën penale pjesëmarrje në rrahje, parashikuar me nenin 155 të KPK. Ndaj të akuzuarve A.C., A.F., është veçuar procedura për shkak se i janë qasur arratisë, kurse me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.301/09, PAkr.nr.34/2013 të akuzuarit G., A.I. dhe A.K. janë shpall fajtor për veprat penale për të cilat janë akuzuar, kurse ndaj të akuzuarve G.R.2 e Xh.C. është refuzuar akuza për shkak të parashkrimit absolut. Ky aktgjykim është anuluar nga kjo Gjykatë, dhe në rigjykim është veçuar procedura edhe ndaj A.K., kurse në rigjykim i akuzuari G. dhe A. janë shpall fajtor për veprat penale për të cilat janë akuzuar. Kjo, Gjykatë e theksoj këtë fakt meqë tani me aktgjykimin e kundërshtuar subjekt shqyrtimi janë vetëm të akuzuarit G.R. e A.I..

Meqë ngjarja ka ndodh në janar gjatë reshjeve me borë nga shkresat e lëndës del se në këtë çështje është bërë dy herë shikimi i vendit të ngjarjes me 2.01.2009 dhe 15.01.2009. Në vend ngjarje trupi i pajetë i të ndjerit A.G., është gjetur në pjesën jugore në afërsi të lumit Prishtevka, një gëzhgjë me mbishkrimin bazë II 90 është gjetur afër Lumit jashtë rrethojave të restorantit “NN1” e evidentuar si VN#3, një shkop druri ngjyrë kafe është gjetur i mbështetur në pjesën e brendshme të oborrit të restorantit, që është evidentuar si dëshmia VN#4, një gëzhgjë me mbishkrimin me bazë BE 439M/M është gjetur në tokë afër derës dalëse nga parkingu i restorantit, e evidentuar si VN#5, një gëzhgjë me mbishkrim me bazë 1165 është gjetur në mes hyrjeve në oborrit të restorantit e evidentuar si VN#6, një gëzhgjë me mbishkrimin në bazë FLB 94x9x19 është gjetur në rrugë në mes të hapësirës së hyrjeve në parkim të restorantit e evidentuar si VN#8, është evidentuar një vrimë depërtuese në një shufër metali në pjesën veriore të rrethojës së oborrit të restorantit e evidentuar si VN#8, dhe është gjetur edhe një bërthamë e brendshme e plumbit në pjesën veriore të një objekti(shupë) që ishte në brendi të rrethojave të oborrit të restorantit, gjurmë këto të cilat edhe janë fotografuar. Është ekzaminuar edhe vetura “Audi 6”, e të akuzuarit A.K. dhe gjatë ekzaminimit në parafangon e krisur është vërejtur vrimë nga predha në pjesën e krahut të majtë të pasmë, gërvishtje ne derën e djathtë të parë, nga hidrauliku

i timonit ka rrjedh vaj, kurse pas tërheqjes se predhë, kjo predhë është evidentuar me nr AD#1.

Sipas raportit të balistikës është konstatuar se dëshmia e dorëzuar VN#3 është një gëzhgjë pjesë përbërëse e fishekut të kalibrit 7.62 mm e cila është gjuajtur nga pushka automatike AK-47 e kalibrit 7.62 x39mm me nr.serik 4219392, dëshmia e dorëzuar VN#5 dhe V#7 janë dy gëzhgoja pjesë e fishekëve të kalibrit 9x19 mm, me bazë të stampuara a) BE 43 9MM-dëshmia VN#5 dhe FLB 94x9x19 – dëshmia VN#7, dëshmia e dorëzuar me VN#6 është pjesë e fishekut të kalibrit 7.62x25mm, me bazë të stampuar 11-65, kurse dëshmia VN#9 është një bërthamë e plumbit(shufër apo metal i fortë) me siguri pjesë e fishekut të kalibrit 7.62x39mm, e cila bërthamë nuk ka karakteristika për krahasime balistike, kurse dëshmia AD#1 e gjetur në veturën e të akuzuarit Atdhe është një plumb/predhë/fysheku e kal.9x19 mm.

Pra, sipas gjurmëve të vendit të ngjarjes vërtetohet se natën kritike janë përdorur tri armë, një pushkë automatike AK-47 e kal.7.62x39mm, të cilën e ka përdorur G.R. dhe e ka dorëzuar pas ngjarjes, dhe dy pistoleta njëra e kalibrit 9x19mm, dhe tjetra e kal.7.62 x 25 mm të cilat nuk janë dorëzuar. .

Janë marrë mostrat e mundshme të grimcave të barotit të marra me tub magnetik nga duart e të akuzuarit A.K. të evidentuar si AK#1 dhe 1.1, dhe duart e të akuzuarit A.I. gjersa gjendej në QKUK, të evidentuar si A.I.#1 dhe 1.1. Kurse, sipas ekspertizës së bërë në Qendrën për hulumtime të Forenzikës “Ivan Vuqetiq”, në Zagreb, nga mostrat e mundshme të grimcave të barotit të marra në duart e A.I. të evidentuar me shenjen A.Idhe 1.1 janë gjet grimcat që janë indikative me mbetjen e përbërësve të kapsollit, e që jep me kuptuar se nga kjo dorë është shtënë me armë zjarri, kurse në duart e A.K. nuk janë gjetë grimcat e barotit.

Sipas raportit të autopsisë të Zyrës për persona të zhdukur dhe Krim teknik datë 9 janar 2009, të kryer nga Dr.M.G. është vërtetuar se shkaktar i vdekjes së të ndjerit A.G., është lëndimi me armë zjarri – depërtimit në gjoks duke dëmtuar aortën, gabzherrin dhe mushkëritë. Kurse, eksperti i balistikës H.K. dhe ai mjeko ligjor T.G., ne ekspertizën e tyre të bërë me shkrim me 11, 12, 13, 20 mars 2009 kanë konstatuar se në bazë të të dhënave nga vendi i ngjarjes, të dhënave të autopsisë, gjetjeve gjatë të shtënave provuese në rastin konkret dëmtimet te tani i ndjeri (në rroba dhe nëpër trup) janë shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës së hudhur nga arma e zjarrit me tytë të gjatë-pushka automatike AK-47 kal.7.62x39 mm, të cilën armë në ngjarjen kritike e ka përdorur i akuzuari G.. Rezulton se në këtë çështje është bërë edhe rekonstruimi i vendit të ngjarjes me 12.01.2012, në të cilën kanë marr pjesë këta ekspert, që të gjithë të akuzuarit e kësaj çështje dhe personat tjerë kompetent, dhe pas rekonstruimit të vendit të ngjarjes ekspertet e lartcekur kanë përpiluar raport me shkrim me datë 12.13.01 dhe 17.02.2012, në të cilin raport kanë mbështetur mendimin e tyre të mëparshëm. Pasi që çështja është thyer në rigjykim në shkallë të parë del se gjykata ka kërkuar edhe nga Agjencioni i Forenzikës së Kosovës që të përcaktoj llojin e armës me të cilin është shtënë në të ndjerin, dhe një grup i tre eksperteve me eksperiencë nga fusha e balistikës kanë konkluduar në mënyrë të njëjtë sikurse eksperti i balistikës dhe ai i mjekësisë ligjore, ndërsa, në rigjykim është dëgjuar edhe Dr.N.U. i cili ka asistuar në autopsinë e të ndjerit i cili po ashtu ka theksuar se plaga vdekje prurës në trupin e të ndjerit është shkaktuar me armë me tytë



të gjatë. Nga shkresat e lëndës del se ngjarja është zhvilluar në prezencë të shumë njerëzve të cilët pas përfundimit të natës festive po dilnin nga restoranti, mirëpo, si dëshmitar të kësaj çështje janë dëgjuar Y.D., B.K., G.Sh. e Sh.D. si dëshmitar okular i ngjarjes.

Kështu, dëshmitarja Y.D., e dashura e të ndjerit A.G., në dëshminë e saj të dhënë në Prokurori me 15.01.2009, ka deklaruar se me të ndjerin natën kritike ka dal me shëtit rreth orës 22:00. Ata kishin planifikuar që të shkonin në restorantin “NN1” meqë kishte muzikë, por për shkak se kishte qenë e sëmurë nuk kishin shkuar. Fillimisht kanë shkuar tek kafet e vogla, ku kanë qëndruar deri rreth orës 24:00, pastaj, kanë shëtitur nëpër qytet dhe deri sa kanë qenë bashkë në ndërkohë dikush e ka thirr në telefon Ab. që të shkoj me pi kafe në “NN1”, me ç’rast Ab. i është përgjigjur se tani nuk mund të shkonte, por, me vonë. Ka qenë me të se bashku deri rreth orës 2.00, e pastaj ka marr taksì dhe ka shkuar në shtëpinë e saj. Në shqyrtimin gjyqësor ajo ka deklaruar se natën kritike kur është ndarë me Ab. para ndërtesës së Gjykatës së Qarkut ai i ka thënë se po e thirr At. në .... Natën kritike i ndjeri i ka pas dy telefonata, dhe asaj i ka thënë se po e thirr xhaxhi me shokët e tij dhe se xhaxhi kishte qenë A.K.. Telefonata e dytë ka qenë rreth orës 24:00 por nuk i kujtohet saktësisht, ka qëndruar me të edhe një orë te kafet e vogla, pastaj kanë shëtitur nëpër qytet deri të Gjykata e Qarkut, ku ajo merr një taksì dhe shkon në shtëpinë e saj, ndërsa, Ab. i thotë se po shkon në lagjen e ...it në restorantin “NN1”. Nuk ka dëgjuar se ai ka pas ndonjë mosmarrëveshje me ndokënd.

Dëshmitari B.K., në dëshminë e tij të dhënë në hetime ka deklaruar se natën kritike së bashku me V.P. dhe G.Sh. kanë qenë në restorantin “NN1”. Rreth orës 2 e 30 ka dal se bashku me V. për të shkuar në shtëpi, kur kanë arritur të dera e hyrjes së në parkingun e restorantit kanë takuar J.K., i cili ka qenë në shoqëri me djemtë e axhës së tij A.K. e A.K., dhe me sa i kujtohet edhe me A.F. i njohur me pseudonimin “Cimi”. Në këtë dëshmi nuk e pranon faktin se kishte njohuri se At. kishte problem me ndokënd duke theksuar se pasi që i ka pyetur “se çka u bo që erdhët kaq vonë dhe çka po bani këtu”, dhe ata i janë përgjigjur “jo kurgjo, jo kurgjo”, së bashku me V. është kthyer që ta marrin veturën që e kishin të parkuar dhe ta marrin G.n pasi që vetura ka qenë e tij, pa arritur të vetura e cila ka qenë e parkuar diku prej derës së hyrjes së restorantit rreth 20 metra larg ka dëgjuar të shtëna dhe ato kanë qenë brr brr, ta,ta,ta brr, brrr, dhe ka pasur gjuajtje jo vetëm prej një arme. Në ato momente është ulur dhe nga telefoni celular ka ftuar policinë dhe policia ka ardhë brenda 5-7 minutave. I njeh si figura G. dhe G.R.2 me nofkat “Sekaqi”, ndërsa, gjatë rrugës duke u kthye të vetura e ka dëgjuar një zë duke thënë “kush k... është ai që na ndjek me thikë”, dhe ky ka qenë zëri i Sekaqit të Madh (G.) dhe kur e ka kthye kokën prapa e ka pa me dy tre persona tjerë diku 5 metra larg. Të ndjerin e ka njohur si njeri të urtë, kurse At. e ka komshi. Në shqyrtimin gjyqësor thekson se gjatë bisedës me J. dhe Ag., njeri prej tyre i ka thënë se At. kishte bërë fjalë me “Sekaqat”, por nuk i kujtohet se cili i ka thënë. Natën kritike e ka parë A.C. në restorant dhe ai ka qenë në shoqëri me G.in ka pas edhe persona të tjerë por emrat nuk ua dinë, atë natë e ka parë edhe Xh.C.n të cilin e njeh vetëm si figurë. Personin me emrin A. nuk e njeh, por natën kritike ka vërejt se ai person ka qenë në ndikimin e alkoolit dhe për emrin e tij dhe plagosjen e tij ka mësuar pas ngjarjes. Natën kritike ka qenë pa uniform me rroba civile ( dëshmitari në kohën kur ka ndodh rasti punonte si polic) dhe pas ngjarjes ka ngel në vendin e ngjarjes derisa kanë ardhur policia. Vendi ku ka mbet i shtrirë Ab. ( i

ndjeri) ka qenë me borë, bora ka qenë e skuqur, i ndjeri ka qenë i shtrirë pak në krah të majtë, ka pas gjakderdhje në gojë dhe në mjekër, por gjak ka pas edhe në tokë. Trupi i pajetë i të ndjerit ka qenë në afërsi të urës, dhe largësia prej vendit ku ka qenë i shtrirë i ndjeri e deri të dyert e restorantit “NN1”, është 20-25m, dhe prej dyerve të restorantit dhe vendit ku ka qenë vetura janë 40-50m largësi. Të ndjerin natën kritike nuk e ka pa as në restorant brenda e as jashtë restorantit. Ka pasur të shtëna rafal dhe të shtënat nga armët tjera kanë qenë një nga një.

Dëshmitari G.Sh. në dëshminë e tij ka theksuar se natën kritike ka qenë mbrëmje festive në restorantin “NN1”, pronar i të cilës është axha i tij Ismet Shala. Atë natë ka qenë se bashku me shokët e tij B.K.n dhe V.P., dhe ka pas shumë mysafir, në mesin e tyre ka qenë edhe Sekaqi i Madh në tavolinë me A.C. dhe disa të tjerë që nuk i ka njohur. Pasi që është përshëndetur me ta kur është nisur për në tavolinën e tij ka dëgjuar kur Sekaqi i madh e ka thirr dhe e ka pyet se a e njeh njëfarë At. të cilin e ka në mëhallë, i është përgjigjur se po dhe se çka është në pyetje. Ndërsa, ai i është përgjigjur se ishin nguc mbrëmë në “NN2” duke i përmend disa persona me mbiemra, por të cilët nuk i ka njohur dhe ka kërkuar që të pajtohen me ta. Ia ka kërkuar numrin e telefonit që të nesërmit të bisedoj me qëllim të pajtimit me ta. Në përfundim të mbrëmjes rreth orës 2: 00 derisa ka qenë duke u përshëndetur me disa mysafir ka vërejtur kur brenda në restorant kanë hyrë A.K. e A.K2.-vllëzër, i ka pyetur se për çka kanë ardhur duke e ditur problemin, pastaj i ka qitur jashtë restorantit që të dytë duke ju thënë që të largohen edhe prej parkingut. Pastaj, ka hyrë në restorant dhe e ka kërkuar Sekaqin e Madh, por nuk e ka gjetur, por ka biseduar me vëllain e tij i ka thënë se kush nga ju ka bërë problem në pompë të benzinës, ndërsa, ai i është përgjigjur se ka qenë ai dhe vëllai i A.“Kikla”( Xh.C.), në atë moment Kikla ka qenë në afërsi të tavolinës së vëllait të tij-A., dhe se bashku kanë shkuar tek tavolina ku ishte A. që të gjejnë ndonjë zgjidhje. Tek tavolina e A. ka qenë edhe një person tjetër i cili ka qenë i pirë, për të cilin mendon se ka qenë A., e të cilin nuk e ka njohur me parë. I ka propozuar Sekaqi të vogël që të siguroj një automjet tjetër ta sjell prapa dyerve të restorantit ku gjendjen hyrja ndihmese e magazinës dhe nëpërmjet asaj dalje të dalin pa u vërejtur nga At. e Ag.. Fillimisht personi i pirë ka kundërshtuar duke thënë se na dalim nga dera kryesore, por pas intervenimit edhe të A.t kanë arritur ta bindin atë dhe G.2 që të dalin nga dera ndihmëse. Pastaj, ka shkuar dhe ka pritur në afërsi të hyrjes ndihmëse të magazinës, por, nuk ka ardh askush, është kthye në restorant, është takuar me G.2 i cili i ka thënë se është bllokuar në parking të restorantit dhe tani vjen, është kthyer përsëri në të njëjtin vend dhe nuk ka ardh askush, meqë e ka ditur se mund të vijë deri të konflikti e ka thirr policinë, dhe kur ka dëgjuar të shtënat ka qenë duke pritur në të njëjtin vend të hyrja ndihmëse. Ka dëgjuar pas rastit “se po të mos ishte A.C. për t’ia qu automatit lart kishte me i vra krejt”.Me të ndjerin është rritë në të njëjtën lagje dhe e ka pas shokë. Ditën kritike nuk është parë me të dhe nuk e din si është gjetur në vend ngjarje, atë natë nuk e ka thirr dhe nuk ka njohuri se kush e ka thirr.

Dëshmitari okular i kësaj çështje, Sh.D., në dëshminë e tij ndër të tjera ka deklaruar se “natën kritike ka shkuar së bashku me shokun e tij Rr. në restorantin “NN1”, aty ka parë G2. me tre shokë të tjerë, prej të cilëve ka njohur vetëm A.I.n, ka vërejtur që më vonë edhe G.. Pas përfundimit të mbrëmjes diku pas orës 2:00, ka dal prej restorantit se bashku me Rr. dhe në restorant ka lenë G.2., G., A. me shokët e tyre. Kur ka arritur të dyert dalëse të oborrit të restorantit ka takuar Ismetin pronarin e

“NN1it” dhe djalin e tij Sh. dhe policin e quajtur B., të cilët i ka dëgjuar duke bërë muhabet lidhur me një mosmarrëveshje ndërmjet disa personave të cilët ishin në hyrje të dyerve të oborrit lidhur me G2.. Ka dal nga automjeti, dhe me të kuptuar se ishte fjala për një problem të G2. ka kuptuar se ata po e pritnin G2., duke thënë se kemi me e rreh. Ka ndërhy duke i lutur ata persona që të largohen se është natë feste, dhe njeri prej tyre i ka thënë janë marrë vesh që ata persona të shkojnë e në këtë ka insistuar edhe Shkëlzeni-që ata të largohen nga dyert e “NN1it”. Është kthyer serish në restorant, ndërsa, Sh. e ka thirr G2. dhe të tjerët dhe u ka thënë se mund të dalin. Kanë dal G.2.it, A.i dhe dy persona tjerë, por personalisht ka hipur në automjetin e G2. në “Tojota” të cilën e ka vozit vetë, ku G. është ulur përpara, kurse A.i dhe dy të tjerë prapa. Me të arritur të dera dalëse e “NN1” ka vërejtur se vetura “Audi 6” e kishte bllokuar rrugën, ndërsa, nga vetura ka vërejtur në këndin tjetër të dyerve një Mercedes të zi Xhip duke bërë lëvizje para e prapa. Në atë moment ka dal nga vetura dhe i ka thënë G2. dhe të tjerëve që mos dalin, dhe ka shkuar të bisedoj me vozitësin e veturës “Audi A6”, i cili e ka pas dritaren e veturës të hapur, dhe i është drejtuar me fjalët “ ne u morëm vesh dhe është festë, për hatër tem, mos u ngucni sot, ka kohë kur mundeni me u marr vesh, nesër pasnesër”, vozitësi e ka pyetur “a je i Makollve”, dhe me qellim që të mos zgjatet muhabeti i ka thënë po, dhe me dorë e ka prek në gjoks-vojitësin me shenjë se u morëm vesh. Në momentin kur ka dashtë të kthehet në veturë është afruar A., i ka sharë dhe ka tentuar mi ra vozitësit të veturës, e ka kap A.in e ka shtyr në drejtim të veturës “Tojota”, por ai serish është vërsul nga vetura duke e nxit situatën, pastaj nga vetura kanë dal të gjithë personat-te pestit që kanë qenë në të, dhe e kanë sulmuar A.in, me grushte dhe me një shipkë të hekurit të gjatësisë 70-80cm, dhe pas kësaj dikush ka repetuar revolen dhe ka shtënë një herë në ajër dhe pas 2-3 sekondave ka parë G. duke dal prej oborrit të “NN1it” ka kaluar nga “Tojota” është pozicionuar dhe ka shtënë me kallash të naltë, gjë që edhe telat e rrymës elektrike kanë qit flakë e cila shtyllë ka qenë në afërsi të urës dhe në afërsi të dyerve të NN1it. Ka arrit të fshihet prapa veturës “Audi”, personi me revole në dorë është pozicionuar afër tij prapa veturës dhe ka dëgjuar kur ka thënë “uh fëmijët e nenës”, dhe ka shtënë në drejtim ku ishte A.i dhe dy tre personat e tjerë, ka shtënë 3-4 herë dhe pastaj kanë hipur në veturë dhe janë larguar në drejtim të ...it. E ka pa G.in pa me armë -kallash, nga grupi tjetër personin me revole për të cilën armë mendon se ka qenë “TT”, dhe nuk ka pa persona tjerë që kanë shtënë apo kanë pasur armë. Pozicioni ndërmjet G.it dhe veturës “Audi” ka qenë 100 m largësi, dhe pas gjithë kësaj pasi që është kthyer në restorant ka kuptuar se është vrapë A.G.- kojshia i atyre djemve. Është e vërtetë se polici B. K. me personat e veturës “Audi 6” ka komunikuar në mënyrë që t’i bind që të largohen nga aty. G.i kur ka dalur me kallash ka dal gati në qoshe të dyerve dalëse në anën e djathtë e që në vijë ajrore barabartë me dëshmitarin, ndërsa me vozitësin “Audi 6”, i ka ra në pozitën si në kënd. G.i ka shtënë tri katër herë rafall, heren e parë naltë, e pasi që ka shtënë me revole personi nga grupi tjetër serish ka dëgjuar të shtëna të kallashit por në çfarë drejtimi nuk ka mundur ta vërej sepse ka qenë i fshehur prapa veturës -Audi. Në shqyrtimin gjyqësor e ka identifikuar At. si personin të cilin e ka pa natën kritike i cili sipas tij ka qenë në veturën “Audi”, dhe që ka pas një shenjë në pjesën e fytyrës nën sy, por është i sigurt se ky person nuk ka pas atë natë armë. Se ka dëgjuar përnjëherë dy të krisme nga armët-nga kallashi dhe nga revolja. G. me kallash ka qenë përball tij, por kur ka shtënë me kallash për herë të dytë është largu 4-5 hapa prapa nga vendi ku shtënë me parë, armën e ka mbajte me dorë në drejtim të tij, por tyta ka qenë pak me lartë mbi kokën e tij dhe larg 6m nga vetura Audi . Te ndjerin A.G.n nuk e ka parë atë natë dhe

nuk e ka njohur me parë, pasi që është kthyer në restorant ka dëgjuar se një person është vra. Ab. e ka parë pasi që është kryer ngjarja dhe ka qenë pas shpinës së tij në momentin kur ka ndodh ngjarja në një distance prej 4-5m., por nuk e ka parë as në vendin e ngjarjes. Në rikonstruim të ngjarjes ka deklaruar se “G. ka shtënë me automatik me dorë lartë dhe pastaj pjerrtas si në të majtë”. I akuzuari G. e ka pranuar veprën penale nga neni 374 të KPK, kurse, veprën penale të vrasjes se rendë nuk e ka pranuar duke theksuar faktin se ai e ka përdorë armën por ka gjuajtur rafal lartë, kurse i akuzuari A. është mbrojtur se natën e ngjarjes nuk i kujtohet asgjë çka ka ndodh.

Bazuar në këtë gjendje të fakteve kontestuese sipas mbrojtëseve të të akuzuarve janë faktet:

1. Se ka mbetë dubioze lloji dhe kalibri i armës prej së cilës është hudhë predha vdekje prurëse për shkak të papranueshmërisë së ekspertizës së ekspertit të balistikës dhe atij mjeko ligjor si provë – dhe konkludimit të tyre jo të drejtë bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve, për çka për zgjidhjen e drejtë të kësaj çështjeje është dashtë të behet super ekspertizë jashtë vendit apo nga një institucion i brendshëm në përbërje nga ekspertet e balistikës dhe atyre të mjekësisë ligjore?

2. Se në bazë të provave të administruara në veprimet e të akuzuarit G. qëndrojnë vetëm elementet e veprës penale nga neni 328 par.1 të KPK kurse, nuk është vërtetuar se i akuzuari G. është shtytur nga i akuzuari A. për ta privuar nga jeta të ndjerit A.G.?

Kjo Gjykatë pas analizimit dhe vlerësimit të provave të lartcekura ka nxjerrë këto përfundime:

Se perse ekspertiza e ekspertit të balistikës dhe atij mjeko ligjor janë të pranueshme si prove është bërë fjalë në kuadër të pretendimeve për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, prandaj kjo Gjykatë se sheh të nevojshme të bëjë vlerësime edhe njëherë. Ekspertet janë persona profesional që thirren në procedure penale që të japin mendimin për faktet kontestuese konkrete. Ndërsa, gjykata nuk është e lidhur me konstatimin dhe mendimin e tyre gjithnjë përderisa nuk e pranon si zgjidhje objektive të çështjes penale. Nga shkresat e lëndës del se gjatë hetimeve me kërkesën e Prokurores dhe urdhëresën e Gjykatës janë angazhuar eksperti i balistikës H.K. dhe ai mjeko Ligjor T.G., që të përcaktohen secili nga domeni i vet për përcaktimin e armës së përdorur e cila ka shkaktuar vdekjen e tani të ndjerit A.G.. Ekspertet kanë kërkuar që tu mundësohet që të bëjnë gjuajtjet provuese nga llojet e armëve që janë përdorur natën kritike dhe posaçërisht pushka automatike e cila është përdorur dhe u është dorëzuar organeve të hetuesisë, e po ashtu kanë kërkuar që ta kenë në posedim edhe jaknën e ngjyrës kafe e cila posedonte dy vrima njëra në supin e majtë e tjetra në gjoksin e majtë e cila i takonte të ndjerit. Pasi që u janë plotësuar kërkesat ekspertët në fjalë kanë bërë të shtëna provuese me pushkën automatike dhe dy lloj armësh tjera (pistoleta) të kalibrave të ndryshme që janë përdorur në ngjarjen e natës kritike, e të cilat nuk janë dorëzuar. Të shtënat janë bërë në periferi të Prishtinës në kondita të ngjashme me ato të vendit të ngjarjes në një kukull e cila ka qenë e veshur me një jakne nga skaji dhe tesha të ngjashme me ato të viktimës që i ka pas të veshur natën kritike, nga distanca 21.30 m (nga arma automatike) ku pozicioni i saj ka qenë i ngjashëm me atë të viktimës, ndera, janë bërë disa të shtëna provuese nga

tre lloj armësh, kalibrash të ndryshme(7.62x25mm, 7.62x39mm dhe 9x19mm). Të shtënat me armët në fjalë bërë edhe në letër hamer nga distancat e sipër cekuar. Janë bërë krahasimet e vrimave hyrëse dhe dalëse dhe është konstatuar se karakteristikat e vrimave hyrëse dhe dalëse në jaknen nga skaji, xhemperin dhe krahoshen me krahë të shkurtër kanë treguar karakteristika identike me të shtënenë që është bërë nga arma automatike AK-47 e cila është dorëzuar për ekzaminim. Janë bërë krahasime mes vrimave hyrëse dhe dalëse në pjesët e gardërobës se kukullës me atë të jaknes së viktimës, të cilën e ka pasur të veshur gjatë ngjarjes kritike. Sipas eksperteve të shtënat nga pistoletat e kalibrit 9x19 mm dhe ajo e kalibrit 7.62x25mm, nuk kanë pas karakteristika as të përafërta me vrimat që janë shkaktuar në jaknen kontestuese nga arma me tytë të gjatë AK-47, dhe në bazë të dhënave nga vendi i ngjarjes, të dhënave të autopsisë, gjetjeve gjatë të shtënave provuese ekspertet kanë konkluduar se dëmtimet të tani i ndjeri(në rroba dhe në trup) janë shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës se hudhur nga arma e zjarrit me tytë të gjatë -pushka automatike AK-47 kal.7.62x39 mm, të cilin mendim ekspertet e kanë dhënë me 11-12-13-20-23 mars të vitit 2009. Pas rekonstruimit të vendit të ngjarjes me 12.01.2012, në raportin e tyre me shkrim ekspertet kanë konkluduar se është vërtetuar edhe me mirë dhe bindshëm se i ndjeri A.G. është qëlluar nga predha e zbrazur nga pushka automatike AK-47 të cilën e ka përdorur G.R., i cili ka shtënë me të njëjtën nga pozicioni para derës së hyrjes së majtë nga parkingut i jashtëm i restorantit “NN1”, ku edhe ka ngelur gëzhoja me.nr.3 që është zbrazur nga e njëjta pushkë automatike. Nga kjo e shtënë i ndjeri në momentin marrjes së plagës ka qenë i kthyer me anën e djathtë të tij dhe atë me pjesën shpinore. Ndërsa, është qëlluar 138 cm vertikalisht dhe lartë nga niveli i shputës së këmbës së djathtë dhe në 16 cm horizontalisht dhe djathtas nga vija e mesme e pasme shpinore(vrima hyrëse) kurse vrima dalëse e kësaj plaje tejshpuese nga arma e zjarrit me tytë të gjatë është në faqën e përparme të majtë të kafazit të kraharorit në zonën e nënkularit (subklaivikulës së majtë). Në rikonstruim është berë edhe interpretimi i vrimave të shkaktuara nga arma e zjarrit në rrethojën e restorantin NN1-gjegjesisht vrimës në gilinder e cila gjendet me afër hyrjes së parë, e cila është 125cm në lartësi nga baza, dhe është në gilinderin e VII të tabelës së dytë. Është përcjellë trajektorja e saj, me dritë të fokusuar dhe ajo trajektore ka vazhduar në vrimën hyrëse, në depon e restorantit e cila është në lartësi nga baza 175 cm, në madhësi 7x6cm(70x60) me një thellësi që shihet deri në 12cm( në këtë thellësi është gjetur bërthama e predhës, e cila nga ekzaminimi laboratorik është konstatuar se është e kalibrit 7.62x39 mm e pushkës automatike. Sipas eksperteve këto dy vrima të shkaktuara nga veprimi dinamik i predhës se hudhur nga arma zjarri me tytë të gjatë japin lidhshmëri me pozicionin apo vendin prej nga ku është shtënë dhe ai për armën përkatëse është i njëjtë me pozitën të cilën e ka konstatuar edhe vet i akuzuari e që ndodhet para hyrjes së majtë të restorantit, gjegjesisht nga parkingu i jashtëm i tij. Mendimet dhe konstatimet e tyre me shkrim këta dy ekspertë i kanë mbrojt edhe me rastin e dëgjimit të tyre në shqyrtimet gjyqësore( ani pse nga shkresat e lëndës rezulton se ekspertet kanë pasur presion në punën e tyre). Në rastin konkret sipas vlerësimit të këtij kolegji konstatimet dhe mendimet e ekspertit të balistikës dhe atij mjeko ligjor janë në harmoni me parimet shkencore, përvojën e tyre profesionale, të gjeturat në vendin e ngjarjes-gjurmët, dhe vet mbrojtjen e të akuzuarit G., prandaj, ky kolegji mendimin dhe konstatimin e tyre se vdekja e të ndjerit është shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës së hudhur nga arma e zjarrit me tytë të gjatë-pushka automatike AK-47, e konsideron si zgjidhje objektive të çështjes. Ndërsa, duke pas parasysh faktin edhe sipas eksperteve të Agjencionit të Forenzikës, madje edhe sipas

ekspertit Dr. Naim Ukës i dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor rrjedh i njëjti konkludim sipas kolegjit të kësaj gjykate nuk shtrohet nevoja për ti evituar dilemat për një super ekspertizë qoftë jashtë shteti apo brenda nga një grup i eksperteve mjeko ligjore dhe atyre të balistikës ashtu siç pretendon mbrojtësi i të akuzuarit G..

Pra, kolegji i kësaj Gjykate vlerëson se nuk ka mbet dubioze përcaktimi i llojit dhe kalibrit të armës me të cilën është privuar nga jeta i ndjeri A.G., kurse, konstatimi dhe mendimi i eksperteve e përjashton mundësinë që i akuzuari me armën automatike të ketë gjuajtur rafal përpjetë. Në fakt edhe pse dëshmitari okular i kësaj ngjarje nuk është konsekuent në dëshminë e tij sa i përket mënyrës se si ka shtënë i akuzuari G. me pushkë automatike kur është dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor në vitin 2010 ka deklaruar se *G.i ka shtënë tri katër herë rafall, herën e parë lartë, e pasi që ka shtënë me revole personi nga grupi tjetër serish ka dëgjuar të shtëna të kallashit por në çfarë drejtimi nuk ka mundur ta vërej sepse ka qenë i fshehur prapa veturës – Audi, ndërsa, në rikonstruim ka thënë se ka shtënë me automatik me dorë lartë dhe pastaj pjerrtas si në të majtë*, prandaj nuk qëndrojnë as pretendimet se dëshmitari okular i kësaj ngjarje i dëgjuar disa herë radhazi ka deklaruar se i akuzuari G. ka gjuajtur rafal përpjetë, kurse, dëshmitari G.Sh. edhe pse ka dëgjuar vetëm të shtënat dhe nuk e ka parë ngjarjen se kush dhe si ka gjuajtur ka deklaruar se pas rastit ka dëgjuar *se po të mos ishte A.C. me ia ngritë dorën lartë kishte me i vra krejt*.

Mirëpo, në kontekst të vlerësimit të gjithmbarshëm të provave të administruara në këtë çështje juridiko penale kjo Gjykatë i vlerësoj veprimet e të akuzuarit G.R. dhe A.I.. I akuzuari G.R. është akuzuar dhe shpall fajtor se ka qenë i shtytur në kryerjen e veprës penale vrasje e rendë, parashikuar me nenin 147 par.4 të KPP në dëm të të ndjerit A.G., kurse i akuzuari A. se e ka shtytë të akuzuarin G. në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rendë, nga neni 147 par.4 lidhur me nenin 24 të KPK. Por, këtë qëndrim të akuzës dhe gjykatës së shkallës së parë kjo Gjykatë nuk e vlerëson si të drejtë.

Për gjetjen e motivit të kryerjes së kësaj vrasje dhe shtytjes në kryerjen e saj, kjo Gjykatë i vlerësoj dëshmitë e dëshmitareve Y.D., B.K., G.Sh. dhe Sh.D. dhe në këtë kontekst edhe mbrojtjet e të akuzuarve G. dhe A., dhe si rezultat i këtyre dëshmimeve dhe mbrojtjes së të akuzuarve kjo Gjykatë konkludon se para çastit kritik i akuzuari A. nuk kishte asnjë motiv për ta shtytur të akuzuarin G. në privimin nga jeta të tani të ndjerit A.G.. Ngase, me asnjë dëshmi nuk vërtetohet fakti se i ndjeri ishte i involvuar qoftë në ngjarjen –konfliktin fizik mes A.it, G2. dhe At.t dhe shokëve të tyre para natës kritike qoftë në ngjarjen e natës kritike, dhe për këtë gjykatë është e çuditshme se në çka e ka bazuar Prokurori por edhe gjykata konkludimin e saj se i ndjeri ishte i involvuar në këtë ngjarje. Dëshmitarët G.Sh., B.K. asnjëri nga ta nuk deklarojnë se të ndjerin e kishin parë në restorant apo me At.n jashtë restorantit, kurse dëshmitari okular i kësaj ngjarje Sh.D. në dëshminë e tij ka dëshmuar se “Ab. nuk e ka njohur dhe nuk e kishte parë atë natë. Vendin e saktë ku ka ngel i shtrirë Ab. e ka vërejt pasi që kishte dal nga restoranti, por, sipas vendit ku e kishte parë me vonë ai ka qenë prapa tij kur është zhvilluar ngjarja në një distancë prej 4- 5 metra, por nuk e ka parë as në vendin e ngjarjes. Edhe dëshmitari B.K. deklaroi se Ab. nuk e kishte parë as në restorant as jashtë tij pos momentit kur e ka parë të shtrirë në afërsi të urës dhe atëherë kishte qenë i vdekur, ndërsa, G.Sh. thekson se nuk e din se si ishte gjetur ai atë natë aty.

Në të vërtetë dëshmitarja Y.D. në dëshminë e saj të dhënë në shqyrtimin gjyqësor deklaroi se gjersa ishte me të ndjerin në qytet natën kritike kur është ndarë me Ab. para ndërtesës së Gjykatës së Qarkut ai i kishte thënë se po e thërriste At. në ..., dhe se atë natë i ndjeri kishte pas dy thirrje-telefonata, kurse asaj i kishte thënë se po e thirr xhaxhi me shokët e tij dhe se xhaxhi ishte A.K., ndërsa, kur ishte ndarë me të ai i kishte thënë se po shkon në lagjen e ... në restorantin NN1. Por, kjo dëshmitare një gjë të tillë nuk e kishte potencuar në dëshminë e saj të parë, ngase kur ka dëshmuar për herë të parë ka deklaruar se deri sa ishin bashkë në ndërkohë dikush e ka thirr në telefon Ab. që të shkoj me pi kafe me të në "NN1", me ç'rast Ab. i është përgjigjur se tani nuk mund të shkonte, por, me vonë. Ka qenë me të se bashku deri rreth orës 2.00, e pastaj ka marr taksì dhe ka shkuar në shtëpinë e saj. Megjithatë edhe nën supozimin se e kishte thirr A. atë natë të ndjerin, sipas mendimit të kësaj Gjykate duke pas parasysh dëshmitë e dëshmitareve tjerë veçanërisht dëshmitarit okular të kësaj ngjarje, kjo thirrje nuk mund të atribuohet involvimit të tij në këtë ngjarje. Bazuar në dëshminë e parë të kësaj dëshmitareje kjo Gjykate vlerëson se i ndjeri pas ndarjes nga e dashura e tij ka rastisur në vendin e ngjarjes pasi që ai jetonte në atë lagje.

Në fakt në bazë të provave të administruara dhe vet mbrojtjes së të akuzuarit G. rezultoi pa mëdyshje se objekt sulmi për të akuzuarin G. ishin personat të cilët po përlesheshin fizikisht me të akuzuarin A.I. . Kështu, nga dëshmia e dëshmitarit G.Sh. rezultoi se natën kritike vet G.i e kishte pyetur për At.n dhe problemin që kishte pasur me të. Ani pse i akuzuari G. e mohon një gjë të tillë ai me rastin e dhënies së deklaratës në polici e ka konfirmuar një fakt të tillë ngase thekson se *"duke dal nga restoranti vëllai i tij G.2. i kishte thënë se Gc. dhe B. e kishin lajmëruar se u kishin zënë priten personat me të cilin kishin pas problem një natë me parë"*. Me tutje thekson se pasi që ata janë dal dhe i kanë lutur grupin tjetër që t'i lënë që të shkojnë ( dëshmitari Gc. deklaroi se u kishte thënë të dilnin nga dyert dalëse të restorantit) pasi që janë dal të dyert e "NN1it", ua kishte zënë rrugën një veturë, ka dal A. nga vetura ka shkuar tek vetura që e kishte bllokuar rrugën, pastaj ka parë se një person i ka ra A.it me një stupc-shkop bejzbolli, dhe menjëherë ka dëgjuar të shtëna armësh, pastaj ka dal nga makina e ka marrë armën dhe dikush e ka kap dhe e ka rrezuar, dhe atij i ka shkrepur arma automatike në ajër në telat e rrymës, pastaj personat që ua kishin zënë rrugën kanë filluar të shtinë me armë zjarri në drejtim të tij, është fshehur pas një kombi dhe ka shtënë edhe 3-4 herë në ajër. Në këtë deklaratë e ka pranuar faktin se vëllai i tij dhe i akuzuari A. kanë pas mosmarrëveshje me disa persona për të cilët deklaroi se kinse nuk i njeh, ndërsa të nesërmit kishte dëgjuar për personin që ishte vrarë, ani pse në deklaratë e tij të mëvonshme e mohon të ketë pasur njohuri për konfliktin e një nate me parë. Edhe i akuzuari A. në mbrojtjen e tij të dhënë në polici ka deklaruar se një natë me parë në ... kishin pas problem me personin A.K. dhe shokët e tij.

Në fakt në bazë të provave të administruara respektivisht dëshmitë e dëshmitareve Sh.D., G.Sh. e B. K., del i vërtetuar fakti se natën kritike i akuzuari Atdhe se bashku me vëllain e tij Agimin, djalin e axhës së tij J. dhe shokun tyre A.F. kishin shkuar në restorantin "NN1", dhe kishin tentuar që të bisedonin me personat me të cilët At. ishte përleshur fizikisht, mirëpo, me ndërmjetësimin e dëshmitarëve të lartcekur ishte arritur marrëveshje që atë natë mos të bisedonin rreth asaj çështje, për

çka në këtë drejtim dëshmitari Sh.D. si dëshmitar okular i kësaj çështje në këtë drejtim është konsekuent në të gjitha fazat e dëshmisë së tij. Situata ka eskaluar duke dal nga restoranti të dyert dalëse derisa dëshmitari Shq. po bisedonte me vozitësin e veturës - Audi pasi që kanë konfirmuar faktin se atë natë janë marrë vesh pas ndërhyrjes së A.i, i cili i është afruar veturës duke sharë dhe ka tentuar ti bjerë me grusht vozitësit të veturës, por përkundër përpjekjes së dëshmitarit që ta largoj A., i njëjti serish është vërsulur drejt veturës, me ç'rast nga vetura dalin të gjithë personat të cilët ishin në të ( sipas shkresave të lëndës del se në veturë kanë qenë At., Ag., Je. dhe A.F.. edhe pse dëshmitari okular thotë se kanë qenë pesë vetë) duke e sulmuar A.in, me grushte dhe me një shkop të drurit të gjatësisë 70-80cm, dhe pas kësaj përleshje fizike pasojnë edhe të shtënat me armë, ku mbetet i vdekur i ndjeri Arben, kurse plagoset rëndë i akuzuari A..

Pra, duke pasur parasysh këtë gjendje të fakteve nuk mund të nxirret përfundimi se i ndjeri A.G. ishte objekt sulmi i të akuzuarit G. dhe as objekt shtytje i të akuzuarit A.. Në fakt të shtënat që i ka ndërmarrë i akuzuari G. ishin të orientuara në drejtim të personave të cilët po përlesheshin fizikisht me të akuzuarin A.I., me ç'rast nga këto të shtëna mbetet i vdekur i ndjeri A.G. i cili bazuar në vendin ku është gjetur i vdekur ishte i pranishëm afër vendit të ngjarjes, por në bazë të provave të administruara assesit i involvuar në ngjarje. Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se nuk mund të qëndroj cilësimi i veprës penale për të cilën është akuzuar dhe shpall fajtor i akuzuari. Në rrethanat e rastit konkret dhe faktet e vërtetuara rezulton qartë se në veprimet e të akuzuarit G. qëndrojnë elementet e veprës penale të vrasjes nga neni 146 të KPK, ngase i akuzuari ishte i vetëdijshëm se me rastin e të shtënave me pushkë automatike në drejtim të personave të cilët ishin objekt sulmi kishte edhe persona tjerë të pranishëm ( që të gjithë dëshmitaret e këtij rasti deklarojnë se ka pas shumë persona të vendi i ngjarjes ngase njerëzit dilnin nga restoranti pas mbrëmjes festive të vitit i 2009), pra, ai ishte i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit të tij dhe ai u pajtua me shkaktimin e saj.

Me këtë rast duhet theksuar se është në kompetencë të Prokurorit ti cilësoj dhe të ndërmerr apo të mos ndërmerr ndjekje penale ndaj çdo kryesi për veprën penale konkrete, se pse nuk janë inkriminuar veprimet e të akuzuarit në drejtim të personave të cilët ishin objekt sulmi nuk bie në domenin e gjykatës të bej vlerësime për këtë, ngase gjykata gjykon në kuadër të akuzës së ngritur, mirëpo, meqë gjykata nuk është e lidhur me cilësimin juridik të akuzës, pa marrë parasysh se disa veprime të të akuzuarit G. kanë mbet të pa inkriminuara e ndryshoj aktgjykimin sa i përket cilësimit juridik të veprës penale.

Gjykata vlerësoj edhe pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se për veprën penale nga neni 374 par.1 të KPK duhet marrë aktgjykim refuzues për shkak se vepra penale është përfshirë në amnisti por vlerëson se këto pretendime nuk janë të bazuara, ngase kur me armë kryhet vrasje apo lëndim i rëndë trupor, armëmbajtja pa leje nuk amnistohet.

Gjykata nuk e pranoj as qëndrimin e akuzës dhe gjykatës së shkallës së parë se i akuzuari A.I. e ka shyt të akuzuarin G. në kryerjen e veprës penale të vrasje të rëndë, parashikuar me nenin 147 par.4 lidhur me nenin 24 të KPK, ngase nga vetë përshkrimi i veprës penale në akuzë dhe dispozitivin e aktgjykimit të kundërshtuar,



por edhe nga provat e administruara rezulton qartë se i akuzuari A.I. nuk ka ndërmarrë asnjë veprim me të cilin me dashje ia ka forcuar mendimin të akuzuarit G. për të kryer veprë penale, por, të gjitha veprimet e tij përfshihen me nxitje të situatës dhe konfliktit fizik në mes tij dhe të akuzuarit A.K. dhe personave që e shoqëronin atë, ngase edhe përkundër arritjes së marrëveshjes se natën kritike mos të ketë probleme në mes veti, ai i afrohet veturës duke sharë dhe tenton ti bjerë vozitësit për çka pastaj pason konflikti fizik edhe përdorimi i armëve.

Për të ekzistuar shtytja nuk kërkohet që vetëm me dashje të shtyhet një person, i cili fare nuk ka ndërmend të kryejë veprë penale, me veprime të caktuara të ndikohet që të formojë vendimin (të vendos) të kryejë veprë penale, apo të ndikohet të personi i cili akoma nuk ka vendosur se a do të kryejë veprë penale të forcohet vendimi i tij, por shtytja duhet të jetë e drejtuar ndaj personi të caktuar si kryes i ardhshëm dhe me qëllim që të kryhet vepra penale e caktuar, vepra konkrete. Dhe nuk mund të ekzistojë shtytja kur një person e shtytë personin tjetër për të kryer vrasje pa e përcaktuar se kush do të vritet. Prandaj, përkitazi me këtë të akuzuar kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret në veprimet e tij nuk përmbushen elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar dhe shpall fajtor, për çka me të drejtë mbrojtësit e tij pretendojnë në ankesën e tyre të përbashkët. Kjo Gjykatë duke pasur parasysh gjendjen e fakteve në këtë çështje vlerësoj se nuk ka nevojë për të administruar prova të reja apo për t'i shqyrtuar edhe njëherë ato ekzistueset, por në praninë e fakteve të vërtetuara për aplikimin e drejtë të ligjit penal, vepra penale për të cilën është shpall fajtor i akuzuari G. duhet ricilësuar, kurse, për të akuzuarin A. duhet nxjerr konkludim tjetër, për çka konform dispozitës së nenit 364 par.1 pika 1 të Kodit të Procedurës Penal të akuzuarin A. e liroj nga akuza. Konform dispozitës së nenit 454 par.1 të KPP shpenzimet e procedurës penale për këtë të akuzuar i ngarkohen mjeteve buxhetore të Gjykatës.

Është jokontestuese se në rastin konkret i akuzuari A. ka pësuar lëndime trupore të shkaktuara me armë zjarri, mirëpo, se kush dhe si i janë shkaktuar këto lëndime nuk janë objekt shqyrtimi në rastin konkret, sepse subjekte të shqyrtimit me aktgjykimin e kundërshtuar janë vetëm të akuzuarit A. dhe G. dhe atë vetëm për veprat për të cilat atyre u vihen në barrë. Në këtë drejtim vlen të theksohet se po ashtu është jokontestuese se nga ekspertiza e bërë në Qendrën për hulumtime të Forenzikës "Ivan Vuqetiq", në Zagreb, nga mostrat e mundshme të grimcave të barotit të marra në duart e A.it janë gjet grimcat që janë indikative me mbetjen e përbërësve të kapsollit, e që jep me kuptuar se nga kjo dorë është shtënë me armë zjarri, mirëpo, Prokurori të akuzuarin A. e ka akuzuar vetëm për shtytje të G.it në vrasje të rendë.

ç). Pretendimet ankimore sa i përket vendimit për dënim përkitazi me të akuzuarin G.R.

Prokurori në ankesë sa i përket kësaj baze ankimore thekson se gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, mirëpo, edhe pse disa rrethana rënduese janë vlerësuar gabimisht gjykata është dashtë të vlerësoj si rrethanë rënduese rrethanat në të cilat është zhvilluar ngjarja ngase është rrezikuar jeta dhe trupi i të gjithë personave të rastisur në vend ngjarje të cilët sapo kishin alur nga ambientet e restorantit ku kishin festuar vitin e ri 2009 dhe se vrasje është kryer me përdorimin e pushkës automatike dhe në praninë e këtyre rrethanave konsideron se

me dënimin e shqiptuar me burgim dhe të me gjobë nuk do të mund të arrihet qëllimi i dënimit. Mbrojtësi i të akuzuarit G. edhe pse e kundërshton aktgjykimin edhe sa i përket kësaj baze ankimore në këtë drejtim nuk je arsye ngase meqë sipas mbrojtësit aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, arsyetimit i vendimit për dënim është i tepërt.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e Prokurorit për një dënim me të ashpër nuk janë të bazuara, kurse ka vend për një dënim me të butë vetëm sa i përket vendimit me burgim.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit si rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka vlerësuar faktin se me parë nuk ka qenë i gjykuar, kurse në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i moshës relativisht i ri, kurse, si rrethanë rënduese ka vlerësuar rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, shkallën e lartë të dashjes duke rrezikuar personat e pranishëm dhe duke shkaktuar vdekjen e një personi i cili ka qenë i pambrojtur dhe se në rastin konkret nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për kryerjen e çfarëdo vepre penale, moshën e re të viktimës, përdorimin e armës automatike të cilën e ka poseduar pa leje, sjellja e të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor në rivendosje jep me kuptuar se nuk është arrit efekti i riedukimit dhe risocializimit.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate rrethanat rënduese të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë gabimisht i ka trajtuar si rënduese ngase nuk mund të trajtohen si të tilla ashtu siç me të drejtë thekson edhe Prokurori, por, nuk mund të trajtohen rrethana rënduese as ato rrethana në të cilat thirret në ankesë Prokurori, ndërsa, duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese veçanërisht moshën e të akuzuarit në kohën e kryerjes së veprës penale si dhe faktin se vepra penale është ricilësuar në një vepër penale dukshëm me të butë, kjo Gjykatë të akuzuari i shqiptoj dënimin me burgim sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se ky dënim është adekuat me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësinë penale të tij, dhe se me të do të mund të ndikohet në parandalimin e tij nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimin e tij, por edhe në parandalimin e të tjerëve nga kryerja e veprave penale, dhe do të forcojë moralin dhe detyrimin e shoqërisë për respektimin e ligjit, respektivisht do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi kondorm dispozitës së nenit 403 të KPP.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË**  
PAKR.nr.345/2016, me 16 shtator 2016

Procesmbajtësja,  
Arta Dumani

Kryetari i kolegjit,  
1.Xhevdet Abazi

Anëtarët e kolegjit:

2. Mejreme Memaj

### 3. Fllanza Kadiu